



MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE
DREJTORIA E ZVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE OFRUESVE TË AFP

PROGRAM KUALIFIKIMI

“PËR MËSIMDHËNËSIT E TEORISË/PRAKTIKËS PROFESIONALE, TË EMËRUAR SI MËSIMDHËNËS ME KOHË TË PLOTË NË OFRUESIT E AFP DHE QË ZOTËROJNË TË PAKTËN DIPLOMË TË NIVELIT MASTER PROFESIONAL OSE TË BARASVLEFSHËM, NË FUSHAT PROFESIONALE PËRKATËSE”

(Grupi A sipas përcaktimit në Udhëzimin nr.21 të MFE, datë 27.6.2022, i ndryshuar)

Tiranë, 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Informacion i përgjithshëm	3
2. Qëllimi i programit të kualifikimit	3
3. Përmbajtja e programit të kualifikimit	4
FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE TË PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR AFP-në	5
FUSHA: DIDAKTIKA DHE VEÇORITË E SAJ NË AFP.....	7
FUSHA: VLERËSIMI I TË NXËNIT NË AFP	14
FUSHA: KRIJIMI I ATMOSFERËS POZITIVE NË PROCESIN MËSIMOR.....	19
FUSHA: MJEDISI DHE MËSIMI DIGJITAL NË AFP	23
FUSHA: ZHVILLIMI PROFESIONAL NË PROFESIONIN PÛRKATËS	29
FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	31
4. Model pyetjesh të provimit të kualifikimit për kategorinë “Mësues i kualifikuar” dhe “Mësues specialist”	33
5. Model i një seance mësimore të hapur për të fituar kategorinë “Mësues mjeshtër”	38
Model 1 – Seancë mësimore teorike	38
Model 2 – Seancë mësimore praktike	43

1. Informacion i përgjithshëm

Programi i kualifikimit profesional për mësimdhënësit e teorisë/praktikës profesionale, të emëruar si mësimdhënës me kohë të plotë në ofruesit e AFP-së dhe që zotërojnë të paktën diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlefshëm, në fushat profesionale përkatëse (grupi A), është hartuar dhe rishikuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësimdhënësve të kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP-së, për të plotësuar kërkesat për marrjen e tri shkallëve të kualifikimit:

- Mësues i kualifikuar
- Mësues specialist
- Mësues mjeshtër

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që Ministria e Financës dhe Ekonomisë (MFE) ka vendosur në Udhëzimin Nr.21, dt. 27.6.2022, i ndryshuar, për mësimdhënësit e teorisë/praktikës profesionale, të emëruar me kohë të plotë në ofruesit e AFP-së dhe që zotërojnë të paktën diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlefshëm, në fushat profesionale përkatëse që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësimdhënësve të kulturës profesionale, të mëposhtme:

- Dokumente zyrtare¹, të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore - zhvillimore të mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP.
- Dokumentacioni në nivel ofruesi të AFP-së.
- Aspekte të pedagogjisë, andragogjisë dhe të metodologjisë në mësimdhënie dhe të të nxëniet në AFP.
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

2. Qëllimi i programit të kualifikimit

Programi i kualifikimit të vazhduar profesional për mësimdhënësit e teorisë/praktikës profesionale, të emëruar si mësimdhënës me kohë të plotë në ofruesit e AFP-së dhe që zotërojnë të paktën diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlefshëm, në fushat profesionale përkatëse, është hartuar për të mbështetur dhe për të nxitur zhvillimin profesional të tyre. Programi është hartuar dhe rishikuar bazuar në përvojën dhe praktikën e mëparshme të zbatuar për kualifikimin e vazhduar të mësimdhënësve të AFP-së nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, si dhe duke mbajtur parasysh përmbushjen e tri qëllimeve kryesore:

1. Të ofrohet si një program orientues në bazë të parimeve të arsimit gjithëpërfshirës, zhvillimit të qëndrueshëm, digjitalizimit dhe të arsimit në formë të dyfishtë (dual), për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësimdhënësve të kulturës profesionale për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, në kuadrin e zhvillimit të vazhduar profesional.
2. Të ofrohet si një program i detyruar veçanërisht për mësimdhënësit që atë vit do të marrin shkallët e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje gjithëvjetoje, për të përballuar me sukses kërkesat e provimit të kualifikimit që bëhet për mësimdhënësit e arsimit profesional për marrjen e shkallëve të kualifikimit
3. Të orientojë ofruesit e trajnimeve të akredituara për mësimdhënësit e AFP që të përgatisin programe në përputhje me kërkesat dhe nevojat reale për kualifikimin dhe zhvillimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve të kësaj kategorie.

Programi synon rritjen e përgjegjshmërisë dhe aftësive të mësimdhënësve të kulturës profesionale për:

- ✚ njohjen dhe zbatimin e legjisllacionit arsimor, e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës së AFP-së;

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MFE që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- ✚ rritjen e aftësive dhe kompetencave profesionale të mësimdhënësve për një mësimdhënie të suksesshme dhe cilësore;
- ✚ domosdoshmërinë e zbatimit të koncepteve dhe ligjësive shkencore të lëndëve/moduleve në praktikë, në përputhje me specifikat e kualifikimit profesional, moshës së nxënësve dhe të kursantëve ku japin mësim;
- ✚ njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në institucionin ofrues të AFP-së;
- ✚ zbatimin me saktësi të rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipes;
- ✚ realizimin në praktikë nëpërmjet demonstrimit konkret të aftësive të fituara, e në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit dhe vëzhgimit.

3. Përmbajtja e programit të kualifikimit

Programi i kualifikimit për mësimdhënësit e teorisë/praktikës profesionale, të emëruar si mësimdhënës me kohë të plotë në ofruesit e AFP-Së dhe që zotërojnë të paktën diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlefshëm, në fushat profesionale përkatëse, është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional të përmendura më sipër, për të cilat kualifikohen mësimdhënësit. Për secilën fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojnë mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike me kohë të plotë në AFP që të përmbushë me sukses edhe kërkesat e provimit të kualifikimit.

Programi është ndërtuar edhe duke pasur si pikënisje standardet e mësimdhënësit të kulturës profesionale. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të kualifikimit do ta ndihmojnë mësimdhënësin e kulturës profesionale që të identifikojë nevojat e tij/saj, si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE TË PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR AFP-në

Kompetenca I: “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • të shpjegojë ligjin për arsimin parauniversitar, duke interpretuar referencat për arsimin profesional; • të interpretojë ligjin aktual të AFP-së, ndryshimet dhe shtesat përkatëse; • të interpretojnë aktet nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e AFP-së; • të interpretojë paketën ligjore që rregullon funksionimin e arsimit profesional në formën të dyfishtë (dual); • të interpretojë Kodin e Punës duke interpretuar referencat lidhen me të drejtat dhe detyrimet e mësimdhënësve; • të interpretojë referencat në Dispozitat Normative për AFP dhe profesionin e mësuesit; • të dallojë elementet kyç të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030; • të bëjë lidhjen midis arsimit profesional, punësimit dhe zhvillimit të aftësive; • të theksojë veçoritë e strukturës së arsimit profesional; • të përshkruajë strukturën institucionale dhe organizative të AFP-së; • të përshkruajë statusin e mësimdhënësit të AFP-së, funksionet dhe detyrat e tij; • të shpjegojë kuptimin e parimeve, udhëzimeve, rekomandimeve dhe formulimeve të tjera që barten në dokumentet bazë të arsimit profesional;	– Ligji “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, Nr. 15/2017, datë 16.02.2017. i ndryshuar me Ligjin nr.32/2024 – Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 56/2015, me Ligjin nr. 48/2018 dhe me Ligjin nr. 44/2023. – Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, në aspektet që lidhen me të drejtat dhe detyrimet e mësimdhënësve dhe ndryshimet me punëdhënësin. – Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030; – Udhëzimi i MEKI nr. 759, datë 30.9.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”. – Urdhër Nr.31, datë 28.1.2020 i ndryshuar me urdhërin Nr. 300, datë 19.6.2024 – Vendimi nr. 691, datë 6.11.2024 “Për përcaktimin e rregullave të veçanta që zbatohen për kontratën e mësimit të profesionit dhe përcaktimin e pagës minimale për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë”. – Urdhër nr. 220, datë 16.09.2020 “Për miratimin e rregullores për zbatimin e praktikave profesionale në biznes në kuadër të ndjekjes së programeve të AFP-së në institucionet publike të AFP-së”. – Udhëzim nr.1090, datë 12.12.2024 “Për procedurat e planifikimit dhe zbatimin e AFP-së në formën e dyfishtë”. – Udhëzimi nr.14 dt 10.7.2023 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë”. – Udhëzimi nr. 15 datë 26.04.2019, “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP”. – Udhëzimi nr. 1090, datë 12.12.2024 “Për procedurat e planifikimit dhe zbatimin

• të shpjegojë me shembuj zbatimin praktik në punën e përditshme të rekomandimeve, udhëzimeve dhe të formulimeve të tjera që barten në dokumentet bazë të AFP-së; • të shpjegojë me shembuj rastet e zbatimit të dokumenteve zyrtare në lidhje me partneritetin social në AFP; • të interpretojë dhe të përdorë dokumentet administrative në ofruesit e AFP-së; • të përdorë dokumentacionin që lidhet me procesin mësimor, skeletkurrikulat, programet e kurseve të unifikuara, kurrikulat në nivel ofruesi (planet mësimore, programet, ditari etj.), instrumentet e vlerësimit, evidencat (regjistrat), certifikatat etj.. • të përdorë regjistrat elektronikë sipas rregullave të përcaktuara; • të interpretojë dokumentacionin mbështetës të procesit mësimor;	e arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë" – Udhëzime për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale, të përvitshme. – Udhëzimi Nr. 21, datë 27.6.2022 “Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimeve të kulturës profesionale në AFP”, i ndryshuar. – Udhëzim Nr.1, datë 8.5.2018 “Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të AFP-së”. – Standardi i profesionit “Mësimdhënës i kulturës profesionale në AFP”, i rishikuar. – Skeletkurrikulat e AFP-së, të publikuara në web-in e AKAFPK, www.akafp.gov.al – Udhëzues i përvitshëm i AKAFPK për ofruesit publik të AFP-së për fillimin e vitit shkollor. – Udhëzuesi metodologjik për hartimin e kurrikulave në AFP . – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Broshurat “Arsimi dhe Formimi Profesional”, nr. 1 – 12, AKAFPK. – Korniza Evropiane e Kualifikimeve (KEK). – Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (KSHK), referencuar me KEK. – Korniza Evropiane e Sigurimit të Cilësisë për AFP-në. – Standardet e Arsimit dhe Formimit Profesional. – Plan i afatmesëm, plani vjetor i shkollës, planet vjetore mësimore, ditari, kontratat e PPB dhe të mësimi të profesionit në biznes. – Dokumentacioni shkollor si regjistrat elektronikë, rubrikat, instrumentet, evidencat etj.. Dokumentacion orientues evropian – Korniza Evropiane për Kompetencat Digjitale të Edukatorëve. – Strategjia Evropiane për Aftësitë (Skills Agenda 2025–2030)
---	---

FUSHA: DIDAKTIKA DHE VEÇORITË E SAJ NË AFP

Kompetenca I: “Zotërimi i njohurive didaktike dhe psiko-pedagogjike/andragogjike specifike të AFP”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: - të shpjegojë konceptet bazë të AFP-së (arsim, arsim profesional, formim profesional, profesion, treg pune, kualifikim profesional, pedagogji, andragogji, psikologji, didaktikë, metodikë, përmbajtje mësimore, objektiv mësimor, metodë mësimore, stil i të nxënësve, media mësimore, vlerësimi i nxënësve, instrument vlerësimi, njohuri, shprehje, qëndrim (sjellje), kompetencë profesionale, kompetencë kyçe, të nxënësve, të nxënësve gjatë gjithë jetës, kurrikul, program mësimor, lëndë mësimore, modul mësimor, standard mësimor, kredit etj.); - të sjellë shembuj konkretë të koncepteve dhe të termave bazë nga lënda/moduli, që lidhen me aftësitë digjitale, të zhvillimit të qëndrueshëm dhe praktikave të gjelbra të fushës profesionale përkatëse; - të përshkruajë veçoritë e të mësuarit të njohurive; - të përshkruajë veçoritë e të mësuarit të shprehive praktike; - të përshkruajë mënyra të zbatimit praktik të konceptit të sipërmarrjes në lëndët apo modulet profesionale; - të analizojë veçoritë e të nxënësve të nxënësve/kursantëve në AFP, lidhur me të mësuarit e njohurive, shprehive praktike, qëndrimeve dhe vlerave; - të përshkruajë konceptin e andragogjisë në AFP, si dhe mënyrën se si nxënësi të rriturit; - të hartojë objektiva mësimore për një njësi mësimore nga lënda/moduli përkatës; - të përzgjedhë përmbajtjet apo veprimtaritë mësimore për një njësi mësimore nga lënda/moduli përkatës;	- Fjalori i Arsimit dhe Formimit Profesional, AKAFPK. - Broshurat Arsimit dhe Formimit Profesional nr. 1–12. - Standardi i mësimdhënësit të kulturës profesionale në AFP, i rishikuar. - Reformimi i kurrikulës së AFP-së, AKAFPK. - Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP-së në Shqipëri. - Manuali “Bazat e Didaktikës në AFP”, i rishikuar 2025. - Udhëzues për mësimin dual në Shqipëri, AKAFPK & MASR 2024. - Manuali për menaxhimin e praktikave profesionale dhe mësimin në punë (work-based learning), 2024. - Udhëzues për përdorimin e platformave digjitale në AFP, MASR–AKAFPK 2023. - Udhëzime dhe materiale mbështetëse që orientojnë për: - ditarin e mësuesit, - hartimin e planeve mësimore, - hartimin e objektivave të orës së mësimit - përgatitjen e detyrave për nxënësit, - organizimin e orës së mësimit. - Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese, me në qendër nxënësin. - Literatura bashkëkohore ndërkombëtare (e përzgjedhur për AFP) Dokumentacion orientues evropian - EQAVET – Korniza Evropiane e Sigurimit të Cilësisë në AFP - DigComp & DigCompEdu – Korniza e kompetencave digjitale - European Key Competences Framework (2018) - EntreComp – Korniza e kompetencave të sipërmarrjes

• të përzgjedhë metoda mësimore të përshtatshme për një njësi mësimore nga lënda/moduli përkatës; • të zbatojë strategji mësimore motivuese dhe gjithëpërfshirjeje me nxënësit /kursantët; • të përcaktojë instrumentin e vlerësimit për vlerësimin e njohurive, shprehive, qëndrimeve dhe vlerave për një njësi mësimore nga lënda/moduli përkatës; • të përshkruajë veçoritë e perceptimit pamor dhe dëgjimor në procesin mësimor; • të analizojë në mënyrë kritike dhe krijuese, objektiva mësimore, përmbajtje mësimore dhe metoda mësimore të dhëna për një njësi mësimore nga lënda ose moduli përkatës; • të japë shembuj nga përvoja si mësimdhënës për motivimin e nxënësve; • të japë shembuj nga përvoja si mësimdhënës, për stilet e të nxënit të nxënësve/kursantëve të veçantë dhe përshtatjen e mësimdhënies ndaj tyre; • të përshkruajë aspekte të menaxhimit të stresit dhe të konflikteve në mësim, si dhe të japë shembuj për to. • të zhvillojë materiale mësimore digjitale në përputhje me përmbajtjen mësimore dhe objektivat e vendosura; • të hartojë instrumente vlerësimi digjitale për vlerësimin e nxënësve/kursantëve; • të aplikojë teknika të ndryshme vizuale dhe audio lidhur me përmbajtje mësimore profesionale; • të përshtatë metodat sipas stileve dhe preferencave të të nxënit të nxënësve/kursantëve; • të përshkruajë metodat për stilet e të nxënit të nxënësve me aftësi ndryshe dhe të përshtatë mësimdhënien për ta, sipas udhëzimeve të përditësuara për arsimin gjithëpërfshirës; • të japë shembuj të integritit të praktikave të sigurisë dhe ergonomisë në procesin mësimor; • të përshkruajë funksionimin e arsimit në formën e dyfishtë në Shqipëri; • të shpjegojë veçoritë e partneritetit shkollë–biznes në mësimin e profesionit;	– Erasmus+ <i>Work-Based Learning Guidelines</i>
--	---

• të përshkruajë rolin dhe bashkëpunimin e mentorit të biznesit me mësimdhënësin e moduleve praktike profesionale apo përgjegjës për arsimin në formë të dyfishtë; • të shpjegojë kontratat e mësimi të profesionit në biznes; • të përshkruajë marrëveshjet me bizneset në AFP. • të shpjegojë monitorimin e praktikave profesionale;	
Kompetenca II: “Zotërimi i parimeve bazë të të mësuarit/nxënit, referuar specifikave të AFP-së”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP, duhet të jetë i aftë: • të përshkruajë kuptimin dhe rëndësinë e parimeve bazë të të mësuarit në AFP: – karakteri shkencor i të mësuarit; – karakteri edukues dhe zhvillues i të mësuarit; – lidhja e teorisë me praktikën; – konkretizimi i mësimi; – karakteri sistematik dhe gradual i të mësuarit; – karakteri i vetëdijshëm dhe aktiv i të mësuarit; – të mësuarit e qëndrueshëm; – përshtatja e të mësuarit me zhvillimin dhe veçoritë e nxënësve/kursantëve. • të lidhë parimet didaktike me kontekstin real të fushës profesionale përkatëse; • të japë shembuj të zbatimit të secilit prej parimeve didaktike bazë në procesin mësimor nga lënda/fusha profesionale përkatëse; • të analizojë në mënyrë kritike dhe krijuese dokumente planifikuese mësimore të dhëna; • të përshkruajë rëndësinë e integritet të koncepteve dhe praktikave të arsimit gjithëpërfshirës, të filozofisë së të nxënit gjatë gjithë jetës, të zhvillimit të qëndrueshëm etj., në procesin e	– Udhëzuesi i AKAFPK për shkollat profesionale publike (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor ne vijim) – Broshurat “Arsimi dhe Formimi Profesional”, nr. 1-12. – Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP- së në Shqipëri. – Faqja e internetit e AKAFPK-së (akafp.gov.al). – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar 2025 – Materialet për gjithëpërfshirjen dhe nxënësit me NEV (nevoja të veçanta) të MA (përfshirë udhëzimet e vitit 2024). – Udhëzuesit e praktikave profesionale dhe manualët për mësimin dual. Dokumentacion orientues evropian – DigCompEdu – Kompetencat digjitale për mësimdhënësit. – EQAVET – Sigurimi i cilësisë në AFP. – European Key Competences Framework (2018). – EntreComp (korniza e sipërmarrjes). – GreenComp (kompetencat e qëndrueshme).

mësimdhënies dhe të nxënies; • të ilustrojë zbatimin e parimeve në laborator/reparte, mjedis biznesi, situata reale të punës; • të vlerësojë qartësinë dhe koherencën objektivave dhe metodave; • të bëjë vazhdimisht lidhjen teori–praktikë; • të përshtatë mësimin me nivelin e nxënësve dhe kërkesat e tregut të punës; • të zbatojë parimin e të nxënit në situata reale; • të zbatojë të nxënit bazuar në zgjidhjen e problemit, të nxënit bazuar në projekte, të nxënit bazuar në punë etj.; • të bëjë lidhjen midis kompetencave profesionale, kompetencave kyçe, aftësive digjitale, aftësive të gjelbra dhe të zhvillimit të qëndrueshëm; • të zbatojë udhëzimet për nxënësit me aftësi ndryshe; • të nxisë kulturën e nxënit gjatë gjithë jetës në profesion; • të shpjegojë integrimin e koncepteve të zhvillimit të qëndrueshëm në procesin mësimor; • të përdorë platforma dhe mjete digjitale për shpjegime, ushtrime profesionale, vlerësime, simulime, materiale vizuale; • të zhvillojë materiale dhe instrumente digjitale të përshtatshme për lëndën/modulin dhe nivelin e nxënësve/kursatëve. • të përshkruajë rolin e reflektimit profesional si parim i zhvillimit të vazhduar; • të përmirësojë metodologjinë bazuar në vetëvlerësim dhe fedback nga nxënësit/mentorët.	
Kompetenca III: “Përdorimi i medieve pedagogjike dhe i TIK në mësimdhënie”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • të shpjegojë kuptimin e mjedisit mësimor, duke dalluar mjedisin fizik (klasa, laborator, reparte) dhe mjedisin digjital (platforma, aplikacione, burime online);	– Broshurat “Arsimi dhe Formimi Profesional”, nr. 1-12. – Fjalori i Arsimit dhe Formimit Profesional (AKAFPK). – Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP-së. – Manuali “Bazat e Didaktikës në AFP”, i rishikuar.

• të shpjegojë kuptimin e “mjeteve mësimore” dhe “materialeve mësimore mbështetëse” në AFP; • të klasifikojë mjetet, mjediset mësimore dhe materialet mësimore mbështetëse sipas funksionit (informuese, laboratorike, praktike, audio-vizuale, digjitale); • të shpjegojë veçoritë e mjediseve profesionale (laborator teknik, reparte mekanike, kuzhinë, IT, sallon estetike, punishte tekstili, mjedise biznesi etj.); • të tregojë kushtet dhe kriteret për mjedisin mësimor të sigurt, të pajisur, ergonomik, gjithëpërfshirës, të përshtatur për standardet e fushës profesionale. • të shpjegojë kuptimin e medieve pedagogjike; • të listojë llojet e medieve pedagogjike (tekstuale, vizuale, audio, manipulues, laboratorike, digjitale); • të përshkruajë veçoritë e përdorimit të medieve në AFP; • të japë shembuj konkretë të përdorimit të medieve mësimore në procesin mësimor, sipas lëndës ose modulit përkatës; (p.sh. simulime virtuale në elektroteknikë, video-procedura në kuzhinë, modele 3D në mekanikë, softuerë CAD në ndërtim, animacione në shërbime sociale); • të argumentojë zgjedhjen e medieve pedagogjike në raport me, objektivat mësimore, nivelin e nxënësve, natyrën e modulit profesional, kërkesat e tregut të punës; • të për zgjedhë mjete dhe platforma digjitale të përshtatshme (Teams, Moodle, Google Classroom, YouTube Edu, Canva, Wordwall, Kahoot, Quizizz, simulime profesionale, aplikacione VR/AR); • të shpjegojë përfitimet e TIK për rritjen e motivimit, rritjen e cilësisë së shpjegimit, simulimin e proceseve profesionale që nuk mund të realizohen në klasë, vlerësimin digjital dhe mësimin e personalizuar; • të përgatisë materiale mësimore digjitale për modulën profesional (video - udhëzime, prezantime interaktive, skema, infografikë); • të përdorë TIK si mjet shpjegimi, mjet vlerësimi, mjet	– Udhëzuesit për mësimin dual dhe për praktikën profesionale. – Udhëzues për përdorimin e platformave digjitale në AFP. – Faqja zyrtare e AKAFPK-së www.akafp.gov.al Dokumentacion orientues evropian – DigComp 2.2 dhe DigCompEdu. – EQAVET – Standardet për sigurimin e cilësisë. – Erasmus+ – Guidelines for Digital VET. – GreenComp – Kompetencat e qëndrueshme.
---	--

vizualizimi, mjet simulimi, mjet bashkëpunues; • të zbatojë kriteret e sigurisë digjitale dhe mbrojtjes së të dhënave sipas udhëzimeve të përcaktuara • të analizojë përparësitë e medieve pedagogjike në procesin mësimor; • të analizojë vështirësitë e medieve pedagogjike në procesin mësimor; • të propozojë zgjidhje konkrete, të përshtatura me realitetin e shkollës profesionale; • të demonstrojë përshtatje të mjedisit edhe me mjete të thjeshta në mungesë të pajisjeve të përparuara. • të identifikojë mjetet dhe mediet më të përshtatshme për orën e mësimi; • të kombinojë mjetet tradicionale me mjetet digjitale; • të përzgjedhë medie që nxisin të nxënit aktiv, bashkëpunimin, zgjidhjen e problemeve, situata reale të punës, simulimin e proceseve profesionale për një njësi mësimore të dhënë, nga lënda/moduli përkatës; • të argumentojë zgjedhjen e medieve në bazë të: parimeve didaktike, standardeve profesionale, sigurisë në punë, specifikave të modulit dhe kompetencave të nxënësve/kursantëve;	
Kompetenca IV: “Planifikimi i procesit mësimor në AFP”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • të shpjegojë kuptimin dhe parimet bazë ku mbështetet planifikimi i procesit mësimor; • të rendisë faktorët që konsiderohen gjatë planifikimit të procesit mësimor (teorik ose praktik); • të shpjegojë si ndikon secili faktor në përzgjedhjen e metodave, ritmit të orës mësimore, vlerësimit, strukturës së planit dhe mjedisit mësimor;	– Udhëzues i përvitshëm i AKAFPK për ofruesit publik të AFP-së për fillimin e vitit shkollor. – Skeletkurrikulat e AFP-së, AKAFPK, https://www.akafp.gov.al/tabela-e-struktures-se-skeletkurrikula/ – Standardet profesionale për të gjitha drejtimitet e AFP-së. – Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP-së në Shqipëri. – Udhëzues për hartimin e objektivave të të nxënit. – Udhëzuesi për përgatitjen e planit vjetor, tematik dhe planit të orës në AFP.

• të shpjegojë veçoritë e procesit mësimor në AFP; • të rendisë dhe shpjegojë fazat kryesore të planifikimit të procesit mësimor (teorik ose praktik); • të hartojë planin e një njësie mësimore (teorike ose praktike) sipas fazave kryesore dhe në përputhje me parimet bazë të planifikimit; • të shpjegojë planin e hartuar dhe të argumentojë përzgjedhjet e bëra; • të analizojë në mënyrë kritike dhe krijuese planin e një njësie mësimore (teorike ose praktike) të dhënë, duke rekomanduar përmirësimet e duhura; • të hartojë plane mësimore që ndërthurin kompetencat profesionale të fushës, aftësitë e qëndrueshme dhe të gjelbra, si dhe kërkesat aktuale të tregut të punës dhe teknologjisë; • të planifikojë procesin mësimor duke respektuar diversitetin e nxënësve; • të përfshijë në planin e mësimdhënies elementë të diferencimit dhe mbështetjes individuale; • të përshtatë planet e mësimdhënies sipas stileve të të nxënësve/kursantëve; • të përdorë mjete digjitale ndihmëse për mbështetjen e nxënësve me aftësi ndryshe; • të shpjegojë zgjedhjet e veta metodologjike; • të planifikojë projekte kurrikulare, ndërnlëndore dhe/ose ndërmodulare; • të planifikojë mjetet/mediet didaktike dhe materiale të tjera për realizimin e një njësie mësimore (teorike ose praktike); • të planifikojë planin e veprimtarive që do të realizohen në biznes duke u bazuar në udhëzimet dhe dokumentet kurrikulare; • të hartojë projekte që bashkojnë disa module ose fusha profesionale; • të planifikojë projekte me partneritet biznesi;	– Broshurat “Arsimi dhe Formimi Profesional”, nr. 1–12. – Fjalori i Arsimit dhe Formimit Profesional, AKAFPK. – Broshura “Standardet e mësimdhënies në AFP”, 2024. – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Manuali i praktikës profesionale dhe mësimi në punë (work-based learning). – Udhëzues për mësimin dual (AKAFPK & MAS, 2024). – Urdhër i MAS nr.589, datë 16.10.2023 “për miratimin e rregullores për përdorimin e sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar” (SMIP). – Materialet për arsimin gjithëpërfshirës dhe mbështetjen e nxënësve me NEV (MAS 2023–2024). Dokumentacion orientues evropian – DigCompEdu – Korniza europiane e kompetencave digjitale për mësuesit. – GreenComp – Korniza europiane e kompetencave të qëndrueshme. – EQAVET – Korniza europiane e sigurimit të cilësisë në AFP.
--	--

• të integrojnë sipërmarrjen, aftësitë digjitale dhe të qëndrueshme; • të orientojnë nxënësit drejt zgjidhjes së problemeve reale të industrisë. • të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet profesionale sipas lëndës/modulit; • të planifikojë përdorimin e medieve digjitale (video, simulime, VR/AR); • të plotësojnë regjistrin elektronik me të dhënat e kërkuara në platformën SMIP sipas rregullave të përcaktuara; • të sigurojnë pajisje për mësim të sigurt dhe ergonomik; • të përdorë materiale të riciklueshme dhe praktika të gjelbra. • të hartojë planin e veprimtarive të nxënësve në biznes sipas kontratës së mësimi të profesionit; • të zbatojnë udhëzimet e AKAFPK-së dhe dokumentet kurrikulare; • të bashkëpunojë me mentorët e bizneseve për monitorimin dhe vlerësimin e nxënësve;	
FUSHA: VLERËSIMI I TË NXËNIT NË AFP	
Kompetenca I: “Parimet, metodat dhe instrumentet dhe llojet e vlerësimit në AFP”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • të shpjegojë kuptimin e vlerësimit të nxënësve/kursantëve në AFP; • të përshkruajë llojet e vlerësimit sipas kritereve të ndryshme; • të tregojë veçoritë e vlerësimit të nxënësve në AFP; • të interpretojë udhëzimet për vlerësimin e nxënësve/kursantëve në AFP;	– Udhëzimi i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 759, datë 30.9.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit” – Broshurat “Arsimi dhe formimi profesional”, nr. 1-12. – Fjalori i arsimit dhe formimit profesional.

• të shpjegojë procedurat e provimeve praktike dhe teorike; • të listojë format dhe metodat e vlerësimit të nxënësve/kursantëve; • të dallojë instrumentet kryesore për vlerësimin e njohurive dhe për vlerësimin e shprehive praktike të nxënësve/kursantëve; • të japë shembuj të instrumenteve të vlerësimit nga lënda/moduli përkatës; • të tregojë kuptimin dhe strukturën e rubrikës së vlerësimit (të njohurive, shprehive, qëndrimeve); • të dallojë instrumente për vlerësimin e njohurive (test, ese, ushtrime teorike); • të dallojë instrumente për vlerësimin e shprehive praktike: lista kontrolli, skeda vlerësimi, rubrika, vëzhgimi i drejtpërdrejtë i punës në laborator/punëtori, detyrat e bazuara në situata reale pune; • të japë shembuj instrumentesh të hartuar për lëndën/modulin që zhvillon; • të përdorë rubrikat për vlerësim formativ dhe përmbledhës. • të japë shembuj konkretë instrumentesh nga lënda/moduli që zhvillon; • të justifikojë zgjedhjen e instrumenteve sipas natyrës së njohurive dhe kompetencave që do të vlerësohen; • të zbatojë parimet bazë të vlerësimit gjatë vlerësimit të njohurive, shprehive, qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve/kursantëve; • të vlerësojë performancën e nxënësve gjatë praktikës në biznes; • të përdorë instrumente për vlerësimin e sigurisë, shprehive teknike dhe sjelljeve profesionale; • të bashkëpunojë me mentorët e biznesit për vlerësim të përbashkët, sipas udhëzimeve të AKAFPK-së; • të dokumentojë progresin e nxënësve në dosjen profesionale të praktikës; • të përdorë platforma digjitale për teste, quice, detyra dhe	– Broshura “Standardet e mësimdhënies në AFP”. – Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP- së në Shqipëri. – Faqja e internetit AKAFPK-së (akafp.gov.al). – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Udhëzuesi për mësimin dual dhe praktikën profesionale (AKAFPK). – Udhëzuesi i AKAFPK për shkollat profesionale publike (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor) – Standardi i profesionit “Mësimdhënës i kulturës profesionale në AFP”, i rishikuar. – Udhëzimi 15, datë 26.04.2019, për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP. – Udhëzimet për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore. – Urdhër i MAS nr.589, datë 16.10.2023 “për miratimin e rregullores për përdorimin e sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar” (SMIP).
--	--

vlërësime (Google Forms, Socrative, Moodle, Wordwall, Kahoot, SMIP); • të krijojë instrumente vlerësimi digjitale të sigurta, të qarta dhe të ruajtshme; • të monitorojë progresin e nxënësve/kursantëve nëpërmjet analizave digjitale të rezultateve; • të vlerësojë nxënësit/kursantët me aftësi ndryshe me instrumente të përshtatshme vlerësimi; • të respektojë standardet etike të vlerësimit profesional; • të vlerësojë me fedback konstruktiv, të qartë dhe të zbatueshëm; • të përdorë vlerësimin për të rritur angazhimin dhe vetëbesimin e nxënësve/kursantëve; • të nxisë vetëvlerësimin dhe përgjegjësinë personale të nxënësve/kursantëve.	
Kompetenca II: “Vlerësimi i njohurisë në AFP”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • të përzgjedhë metodat dhe instrumentet e duhura të vlerësimit për situata të ndryshme mësimore (teorike); • të hartojë instrumente të thjeshta të vlerësimit të nxënësve/kursantëve për nivele të ndryshme të njohurive; • të hartojë lloje të ndryshme instrumentesh për vlerësimin e nxënësve për nivele të ndryshme të njohurive nga lënda ose moduli përkatës; • të shpjegojë mënyrat e organizimit të provimeve përfundimtare në AFP (teorike); • të hartojë instrumente të vlerësimit për nivele të ndryshme të njohurive; • të përgatisë pyetje dhe detyra të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të matshme; • të integrojë përdorimin e TIK-ut;	– Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Udhëzues i përvitshëm i AKAFPK për ofruesit publik të AFP-së për fillimin e vitit shkollor. – Udhëzimi i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 759, datë 30.9.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit” – Udhëzues praktik për hartuesit e testeve me zgjedhje të shumëfishtë – Standardi i profesionit “Mësimdhënësi i kulturës profesionale në AFP”, i rishikuar.

• të integrojë aftësi të punës si: komunikimi, organizimi i punës etj.; • të hartojë pyetje me përgjigje të mbyllura dhe të hapura që matin mendimin kritik dhe arsyetimin profesional; • të hartojë probleme të zgjidhshme, ushtrime llogaritëse, analiza skemash, interpretime hartash teknike etj.; • të përgatisë teste digjitale, duke përdorur Google, platforma të sigurta (Forms, Moodle, Socrative); • të hartojë një test për vlerësimin përfundimtar të njohurive të nxënësve/kursantëve në lëndën profesionale përkatëse apo aspektet teorike të modulit profesional përkatës; • të ndërtojë një plan të vlerësimit të nxënësve/kursantëve për një proces mësimor të dhënë (temë, kapitull, etj.) dhe të hartojë instrumentet përkatëse të vlerësimit; • të analizojë në mënyrë kritike dhe krijuese një instrument kompleks (rubrikë) vlerësimi të dhënë; • të analizojë rezultatet e vlerësimit të një grupi nxënësish dhe të nxjerrë konkluzionet e duhura; • të japë shembuj të llogaritjeve të mesatare të ponderuara duke konsideruar vlerat e krediteve dhe koeficientëve të tjerë.	
Kompetenca III: “Vlerësimi i shprehisë praktike në AFP”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • të përzgjedhë metodat dhe instrumentet e duhura të vlerësimit për situata të ndryshme mësimore të shprehisë praktike; • të shpjegojë mënyrat e organizimit të provimeve përfundimtare të shprehisë praktike në AFP; • të përshkruajë detyrat e komisionit të vlerësimit të provimeve përfundimtare; • të hartojë instrumente të thjeshta të vlerësimit të nxënësve/kursantëve për nivele të ndryshme të shprehisë praktike;	– Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Udhëzues i përvitshëm i AKAFPK për ofruesit publik të AFP-së për fillimin e vitit shkollor. – Urdhër nr 220, datë 16.09.2020 për miratimin e rregullores “Për zbatimin e praktikave profesionale në biznes në kuadër të ndjekjes së programeve të afp- së në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional”. – Vendim Nr. 691, datë 6.11.2024 “Për përcaktimin e rregullave të veçanta që zbatohen për kontratën e mësimi të profesionit dhe përcaktimin e pagës minimale për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional

• të hartojë lloje të ndryshme instrumentesh për vlerësimin e nxënësve për nivele të ndryshme të shprehisë praktike ose moduli përkatës; • të hartojë instrumente komplekse (rubrika) për vlerësimin e nxënësve dhe të llogarisë rezultatin e vlerësimit të nxënësve me to; • të hartojë një listë kontrolli/udhëzues përmbushjeje për vlerësimin përfundimtar shprehisë praktike të nxënësve/kursantëve të modulit përkatës profesional; • të analizojë në mënyrë kritike dhe krijuese një instrument kompleks (rubrikë) vlerësimi të dhënë; • të analizojë rezultatet e vlerësimit të një grupi nxënësish për një shprehje praktike dhe të nxjerrë konkluzionet e duhura; • të japë shembuj të llogaritjeve të mesatareve të ponderuara duke konsideruar vlerat e krediteve dhe koeficienteve të tjerë; • të interpretojë referencat për vlerësimin e nxënësve në biznes sipas rregullores për zbatimin e praktikave në biznes; • të vlerësojë performancën profesionale të nxënësve në situatën reale të punës; • të analizojë rezultatet dhe të propozojë masa për përmirësim.	në formën e dyfishtë”. – Udhëzim Nr.1090, datë 12.12.2024 “Për procedurat e planifikimit dhe zbatimin e arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë”. – Standardi i profesionit “Mësimdhënës i kulturës profesionale në AFP”, i rishikuar. – Udhëzues praktik për praktikantët e shprehive profesionale dhe hartimin e rubrikave.
Kompetenca IV: “Vlerësimi i qëndrimeve dhe vlerave në AFP”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • të përzgjedhë metodat dhe instrumentet e duhura të vlerësimit për qëndrime dhe vlera; • të hartojë instrumente të thjeshta të vlerësimit të nxënësve/kursantëve për nivele të ndryshme të qëndrimeve dhe vlerave; • të hartojë lloje të ndryshme instrumentesh për vlerësimin e nxënësve për nivele të ndryshme të qëndrimeve dhe vlerave nga lënda ose moduli përkatës; • të hartojë instrumente vlerësimi për “aftësitë e buta”;	– Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar – Udhëzues i përvitshëm i AKAFPK për ofruesit publik të AFP-së për fillimin e vitit shkollor. – Vendim Nr.691, datë 6.11.2024 “Për përcaktimin e rregullave të veçanta që zbatohen për kontratën e mësimin të profesionit dhe përcaktimin e pagës minimale për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë”. – Udhëzimi Nr.1090, datë 12.12.2024 “Për procedurat e planifikimit dhe zbatimin e arsimit dhe formimit profesional në

• të përdorë instrumentet e vlerësimit në situata reale profesionale dhe të reflektojnë veprimet e nxënësve në mjedisin e AFP-së dhe në biznes; • të hartojë instrumente komplekse (rubrika) për vlerësimin e nxënësve dhe të llogarisë rezultatin e vlerësimit të nxënësve me to; • të hartojë njësi testi për vlerësimin përfundimtar të qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve/kursantëve në lëndën profesionale përkatëse apo aspektet teorike të modulit profesional përkatës. • të krijojë situata të simuluar që matin reagimin etik të nxënësve; • të përdorë instrumente të vlerësimeve të ndryshme në laboratorë, reparate pune, kompanitë (mësimi i dyfishtë); të integrojnë elementet e digjitalizimit (sjellje në platforma online, komunikim profesional) dhe të qëndrueshmërisë (etika mjedisore);	formën e dyfishtë”.
FUSHA: KRIJIMI I ATMOSFERËS POZITIVE NË PROCESIN MËSIMOR	
Kompetenca I: “Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësimdhënësit”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • të njohë rregullat e etikës dhe të sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; • të zbatojë rregullat e etikës dhe standardet etike brenda dhe jashtë institucionit arsimor; • të tregojë neutralitet, profesionalizëm dhe respekt gjatë mësimdhënies dhe komunikimit; • të komunikojë në mënyrë profesionale, të qartë dhe të strukturuar me mentorët e bizneseve dhe përfaqësuesit e tyre; • të respektojë protokollet e bashkëpunimit për mësimin e dyfishtë	– Kodi i Etikës së mësimdhënësve në arsimin parauniversitar. – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”. – Udhëzues dhe dokumente zyrtare të AKAFPK-së për kualifikimin e mësimdhënësve të AFP-së https://www.akafp.gov.al/kualifikimi-i-vazhduar-i-mesimdhenesve/ – Materiale udhëzuese për bashkëpunimin me biznesin dhe mentorët në arsimin në formën e dyfishtë;

dhe praktikat profesionale; • të sillet dhe të marrë vendime në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor; • të reagojë profesionalisht në situatën konfliktuale, duke përdorur teknika të komunikimit paqësor dhe konstruktiv; • të ruajë etikën e komunikimit verbal, joverbal dhe etikën në komunikimin digjital; • të ndërtojë marrëdhënie pozitive me nxënësit; • të dallojë barrierat e komunikimit të nxënësve dhe grupmoshave të ndryshme; dhe të zbatojë teknika të kapërcimit të tyre; • të dallojë standardet bazë të mësuesit në lidhje me komunikimin në procesin mësimor në AFP; • të përshtatë stilin e komunikimit me nevojat e nxënësve/kursantëve; • të krijojë një atmosferë të sigurt dhe mbështetëse për çdo nxënës/kursant; • të përdorë gjuhë teknike profesionale, të sjellshme dhe motivuese; • të shmangë gjykimet, etiketimet dhe ndryshimet që dëmtojnë dinjitetin e nxënësve/kursantëve; • të demonstrojë menaxhimin profesional të situatave të ndjeshme, duke e bërë të ditur dhe konfidencialitetin; • të marrë vendime në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij, brenda dhe jashtë institucionit arsimor; • të krijojë një mjedis të sigurt dhe etik mësimor;	
Kompetenca II: “Zhvillimi i aftësive kyçe të nxënësve të rinj dhe të rritur”	Literatura e rekomanduar

Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • të shpjegojë kuptimin për “aftësitë kyçe” në AFP; • të argumentojë rëndësinë e integritit të aftësive kyçe në përmbajtjet mësimore dhe në procesin mësimor në AFP; • të jetë fleksibël në zgjedhjen e strategjive mësimdhënëse që nxisin risitë dhe dijet personale; • të përshtatë strategjitë sipas stileve të të nxënësve, niveleve të grupit dhe kërkesave për të punuar; • të zbatojë strategji për menaxhimin e kohës që krijojnë mundësi për zhvillimin e karrierës në vendin e punës; • të instruktojë nxënësit/kursantët të organizojnë detyrat, prioritetet dhe detyrat profesionale; • të motivojë nxënësit për vetëmenaxhim; • të jetë i hapur dhe aktiv, për t’i përdorur kolegët, mentorët e biznesit dhe profesionistët e tjerë si burim për të mësuar dhe si burim frymëzimi; • të kontribuojë në gjithë proceset e zhvillimit dhe të nxënësve të komunitetit të shkollës; • të ndërtojë partneritete për nxënësit gjatë praktikave profesionale; • të përshtatë praktikën e mirë me kolegëve dhe të ndihmojë për të krijuar mjedis mësimor të pasur; • të zhvillohet profesionalisht për të rritur efikasitetin në mësimdhënie, si edhe ekspertizën në lëndën/modulin që zhvillon; • të përfshihet në mbledhje dhe aktivitete të komunitetit të nxënësve/kursantëve dhe stafit për përmirësimin e kulturës së mësimdhënies; • të ndajë praktikën e mirë me kolegët dhe mentorët e biznesit; • të pasurojë mjedisin mësimor me ide dhe zgjidhje të reja pedagogjike; • të përdorë instrumente dhe metoda mësimore për përmbushjen	– Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Profesional 2023–2030. – Komisioni Evropian, DG – Arsimit dhe Kultura (2011). – Udhëzimi i fundit për kualifikimin e mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP. – Vendim Nr.691, datë 6.11.2024 “Për përcaktimin e rregullave të veçanta që zbatohen për kontratën e mësimit të profesionit dhe përcaktimin e pagës minimale për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë”. – Udhëzim Nr.1090, datë 12.12.2024 “Për procedurat e planifikimit dhe zbatimit të arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë”. – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të zhvillimit të aftësive kyçe të nxënësve të rinj dhe të rritur https://eurydice.eacea.ec.europa.eu/publications/developing-key-competences-school-europe-challenges-and-opportunities-policy https://education.ec.europa.eu/focus-topics/digital-education/tools-for-schools-and-educators
---	--

e objektivave në fushën e të nxënit social dhe emocional; • të zhvillojë kompetenca kyçe - me një theks të veçantë tek aftësitë e shkrimit dhe leximit, aftësitë numerike dhe dixhitale.	
Kompetenca III: “Zbatimi i parimeve të barazisë, gjithëpërfshirjes, diversitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në procesin mësimor”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • të shpjegojë kuptimin e “barazisë”, “gjithëpërfshirjes”, “personave me nevoja të veçanta” dhe “diversitetit” në kontekstin e AFP-së; • të japë shembuj të zbatimit të parimeve të barazisë, gjithëpërfshirjes dhe diversitetit në procesin mësimor në AFP; • të krijojë një mjedis të sigurt, mbështetës dhe ekologjikisht të qëndrueshëm, ku të gjithë nxënësit ndihen të përfshirë dhe të motivuar; • të përfshijë të gjithë nxënësit në projekte dhe ngjarje sociale; • të integrojë në mësim tema si të drejtat e njeriut, barazia sociale dhe gjinore, gjithëpërfshirja dhe edukimi mjedisor; • të zhvillojë aktivitete që i inkurajojnë nxënësit të kontribuojnë aktivisht në komunitet dhe në mjedisin e qëndrueshëm të shkollave; • të përdorë kulturën e hapur, mediet dhe teknologji moderne digjitale për të rritur ndërgjegjësimin e nxënësve/kursantëve mbi konceptet e mësipërme; • të kontribuojë në hartimin e politikave të shkollës për luftën kundër diskriminimit dhe përjashtimit; • të aktivizojë nxënësit në përmirësimin e përfshirjes sociale; • të njohë format e diversitetit: etnik, kulturor, gjuhësor, social, ekonomik, gjinor, aftësi dhe stil të nxëni; • të parandalojë stereotipet, paragjykimet dhe format e	– Manuali “Nxitja e kulturës demokratike dhe diversitetit në shkolla. – Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023 – 2030. – Dokumente dhe udhëzime të AKAFPK mbi AFP, praktikat në biznes, modelin dual dhe përdorimin e teknologjisë digjitale në procesin mësimor. – Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligji nr. 56/2015, me Ligji nr. 48/2018 dhe me Ligji nr. 44/2023. – Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. – Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025. – Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të barazisë, gjithëpërfshirjes dhe diversitetit në procesin mësimor. – Literatura dhe materiale burimore mbi barazinë, gjithëpërfshirjen, diversitetin, aftësitë e buta, qëndrueshmërinë dhe digjitalizimin në arsimin profesional.

diskriminimit; • të krijojnë një klimë respekti, empatie dhe bashkëpunimi në klasë dhe ambientet profesionale; • të njohë diversitetin brenda dhe përtej grupeve etnike; • të zbatojë parimet e barazisë, gjithpërfshirjes dhe diversitetit në procesin mësimor; • të ofrojë metodologji dhe burime në procesin mësimor, bazuar në parimet e barazisë, gjithpërfshirës dhe diversitetit; • të sigurojë që detyrat, burimet, instrumentet dhe metodat të aksesohen për të gjithë nxënësit; • të përdorë shembuj, raste studimore dhe materiale që reflektojnë diversitetin; • të përfshijë tema të zhvillimit të qëndrueshëm në mësimet teorike dhe praktike profesionale; • të sigurojë një proces të drejtë, transparent dhe të paanshëm; • të promovojë aftësitë sociale dhe të buta si bashkëpunimi, solidariteti, empatia, etj.; • të promovojë grupet e nxënësve të marrin rol aktiv në projekte për mjedisin dhe komunitetin; • të nxisë vetëdijen e diversitetit dhe të drejtave të njeriut; • të edukojë nxënësit me parimet e kulturës së kujdesit, respektit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.	
FUSHA: MJEDISI DHE MËSIMI DIGJITAL NË AFP	
Kompetenca I: “Përgatitja dhe mirëmbajtja e mjedisit dhe mjeteve për mësimin digjital në AFP”	Literatura e rekomanduar

Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • të shpjegojë kuptimin për “mjedisin digjital”, “mjetet digjitale” dhe “mësimi digjital”; • të dallojë elementet gjithëpërfshirëse të mjedisit digjital në AFP; • të tregojë veçoritë e përgatitjes dhe përdorimit të mjedisit dhe mjeteve digjitale në AFP; • të argumentojë përparësitë dhe vështirësitë e përgatitjes dhe përdorimit të mjedisit dhe mjeteve digjitale në mësimin teorik dhe praktik; • të japë shembuj të përdorimit të mjedisit dhe mjeteve digjitale në procesin mësimor, për një njësi mësimore nga lënda/ moduli përkatës; • të vlerësojë mjetet digjitale sipas funksionalitetit, qëndrueshmërisë dhe përshtatshmërisë për lëndën/modulin profesional; • të propozojë përdorimin e teknologjisë për mësimin praktik në situata të ndryshme; • të kontrollojë paraprakisht mjedisin dhe mjetet digjitale para orës së mësimi; • të sigurojë funksionim të pandërprerë të mjetit digjital gjatë seancës mësimore; • të zbatojë protokollet e sigurisë digjitale, privatësisë së të dhënave dhe etikës online; • të administrojë mjedisin digjital të klasave (organizimi i skedarëve, strukturimi i orës, shpërndarja e materialeve online); • të përdorë mjetet për monitorimin e progresit të nxënësve; • të zbatojë rregullat e sigurisë digjitale: integrimin e të dhënave, praktikat e virusit, privatësia e nxënësve, integriteti i informacionit; • të përdorë programe të sigurta dhe softuerë profesionalë të	– Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të mjedisit dhe mësimi digjital. – Literatura mbi mjedisin dhe mësimin digjital (DigComp, DigCompEdu). – Udhëzues për mësimin dhe vlerësimin në kushtet e shtëpisë, për lëndët profesionale dhe modulet profesionale në Arsimin Profesional Tiranë, 23.03.2020 – Udhëzues i përvitshëm i AKAFPK për ofruesit publik të AFP, për fillimin e vitit të ri shkollor
--	--

ngjashëm me ata të industrisë; • të integrojë platforma digjitale për simulime teknike, përpunim të të dhënave, projektim, analizë dhe trajnime praktike; • të lidhë mësimin digjital me praktikën profesionale dhe sistemin dual.	
Kompetenca II: “Përgatitja e materialeve didaktike digjitale për mësimin digjital në AFP”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • të shpjegojë kuptimin e “materialeve didaktike digjitale” dhe rolin e tyre në proceset e të nxënit në AFP; • të shpjegojë lidhjen midis materialeve digjitale dhe të kompetencave profesionale, digjitale dhe kyçe të nxënësve; • të tregojë lloje dhe formate të materialeve mësimore digjitale në mësimin teorik dhe praktik; • të tregojë rëndësinë e përgatitjes së materialeve mësimore digjitale në funksion të procesit mësimor në AFP; • të përdorë teknika të përgatitjes dhe përdorimit të materialeve mësimore digjitale në mësimin teorik dhe praktik; • të japë shembuj të përdorimit të materialeve mësimore digjitale në mësimin teorik dhe praktik; • të përzgjedhë burimet e duhura për marrje informacioni për përgatitjen e materialeve mësimore; • të identifikojë dhe klasifikojë materialet digjitale sipas natyrës së tyre; • të klasifikojë formatet digjitale sipas përdorimit në mësimdhënie: deklaratë, udhëzime video, punë praktike të ilustruara, situata problem, teste online; • të dallojë materialet që përdoren në mësimin teorik dhe/ose praktik, si dhe për mësimin në formën e dyfishtë;	– Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Materiale burimore që trajtojnë çështje të mësimin digjital dhe përdorimin e mjeteve digjitale https://skillsforjobs.al/wp-content/uploads/2024/11/Materialet-Digjitale.pdf – Udhëzues i përvitshëm i AKAFPK për ofruesit publik të AFP, për fillimin e vitit të ri shkollor.

• të argumentojë funksionin e materialeve digjitale në procesin mësimor; • të zbatojë teknika të ndryshme të përgatitjes së materialeve digjitale; • të përzgjedhë burime e materiale të sakta, të besueshme dhe profesionale; • të vlerësojë burimin, relevancën dhe besueshmërinë e informacionit të marrë online; • të përdorë materiale digjitale për orientimin në biznes, për udhëzime praktike dhe për dokumentimin e shprehive profesionale; • të krijojë materiale digjitale që të përdoren nga nxënësit/kursantët gjatë praktikave profesionale; • të integrojë platforma profesionale digjitale të industrisë për simulime dhe trajnime të aplikuara; • të përgatisë nxënësit për teknologji reale të punës;	
Kompetenca III: “Përgatitja e instrumenteve dhe kryerja e vlerësimit digjital të nxënësve dhe kursantëve”.	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • të shpjegojë qartë kuptimin e “vlerësimit digjital”; • të argumentojë rëndësinë e vlerësimit digjital në mësimin modern, fleksibël dhe të qëndrueshëm; • të evidentojë rolin e vlerësimit digjital në përmirësimin e transparencës, efikasitetit, objektivitetit dhe aksesueshmërisë në AFP; • të dallojë mundësitë dhe variacionet e testeve digjitale për qëllime të ndryshme, të përshtatura për platforma dhe programe të ndryshme; • të përshtasë vlerësimin digjital sipas nivelit të nxënësve,	– Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Materiale burimore që trajtojnë çështje të mjedisit dhe mësimin digjital. – Udhëzues i përvitshëm i AKAFPK për ofruesit publik të AFP, për fillimin e vitit të ri shkollor – Manuale të përdorimit të platformave online.

lëndës/modulit dhe objektivave të AFP; • të ndërtojë instrumente vlerësimi të llojeve të ndryshme; • të përdorë platforma të tilla si <i>MS Teams, Moodle, Google Forms, Testportal, Kahoot, Quizizz, OpenEdx</i>, etj., për të zhvilluar teste digjitale; • të dallojë tipologjitë e testeve digjitale dhe përshtatjen e tyre sipas platformës; • të zgjedhë formate vlerësimi në përputhje me objektivat e lëndës, nivelin e nxënësve dhe natyrën e mësimit; • të dallojë veçoritë e testeve të zhvilluara në mjedis Interneti (online) dhe mjedis të mbyllur lokal (Local Area Network - LAN); • të tregojë lloje të ndryshme të njësive të testeve digjitale; • të japë shembuj në lidhje me llojet, formatet e instrumenteve të vlerësimit digjital dhe teknika të përgatitjes dhe përdorimit të instrumenteve të vlerësimit digjital; • të sigurojë mbrojtjen e të dhënave të nxënësve dhe etikën e vlerësimit online; • të analizojë veçoritë e përdorimit të instrumenteve të vlerësimit digjital në mjedisin mësimor digjital, duke shmangur mundësinë e hakërimit; • të analizojë veçoritë e zhvillimit të formatit të kombinuar (blended) ose online – të sinkronizuar; • të përshtatë detyrat digjitale sipas kohës, ritmit dhe mundësive të nxënësve në mjedisin online; • të përdorë raportet analitike të platformave digjitale (<i>Google Forms, Moodle, Teams, Testportal</i>, etj.) për të analizuar performancën e nxënësve; • të personalizojë vlerësimin digjital duke krijuar detyra të diferencuara; • të përdorë analizat digjitale si bazë për përmirësimin e mësimdhënies dhe të instrumenteve të vlerësimit.	
---	--

Kompetenca IV: “Realizimi i mësimi online dhe të kombinuar (<i>blended</i>) dhe përdorimi i komuniteteve të praktikave online”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • të dallojë formatet kryesore të mësimi online (sinkron, asinkron) dhe të mësimi të kombinuar (<i>blended learning</i>); • të shpjegojë veçoritë, përparësitë dhe kufizimet e secilit format në kontekstin e AFP-së; • të zgjedhë formatin e përshtatshëm në varësi të lëndës/modulit, natyrës teorike ose praktike të përmbajtjes dhe nevojave të nxënësve; • të zhvillojë dhe zbatojë forma efektive të mësimdhënies online dhe <i>blended</i>, duke përdorur platforma të ndryshme digjitale; • të përdorë metoda pedagogjike inovative dhe aktivitete interaktive (diskutime online, punë në grupe virtuale, simulime, projekte digjitale); - të japë shembuj të përgatitjes dhe zhvillimit të mësimi online dhe të kombinuar, për një njësi mësimore nga lënda/ moduli përkatës; • të integrojë metoda pedagogjike inovative të përshtatura për mjedisin online dhe për nxënës me stile të ndryshme të të nxënës; • të ilustrojë me shembuj praktikë organizimin e një seance mësimore online ose të kombinuar; • të përdorë internetin dhe komunitetet e praktikës online për zhvillimin e vazhdueshëm profesional; • të shfrytëzojë platforma dhe rrjete profesionale për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira; • të përditësojë njohuritë pedagogjike dhe profesionale përmes burimeve digjitale të besueshme. • të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të medieve digjitale dhe	– Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Udhëzues i përvitshëm i AKAFPK për ofruesit publik të AFP, për fillimin e vitit të ri shkollor. https://mesovet.al/assets_uat/docs/Document-5.pdf

rrjeteve sociale në funksion të procesit mësimor në AFP; • të përdorë medie digjitale në mënyrë të përgjegjshme; • të marrë pjesë aktive në rrjete profesionale online për shkëmbimin e praktikave të mira; • të kontribuojë në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet mësimdhënësve të AFP-së; • të përdorë komunitetet digjitale për zhvillimin e projekteve, inovacionit pedagogjik dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.	
FUSHA: ZHVILLIMI PROFESIONAL NË PROFESIONIN PÛRKATËS	
Kompetenca I: “Kompetenca intelektuale dhe pedagogjike”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • Të zbatojë njohuritë ekzistuese; • të vendosë marrëdhënie pedagogjike të përshtatshme, në përvetësimin dhe transformimin e njohurive; • të analizojë, sintetizojë, krahasojë dhe manifestojë cilësitë e inteligjencës dhe të të menduarit kritik; • të hartojë standarde lëndore; • të përcaktojë kriteret për arritjen e standardeve lëndore; • të integrojë njohuritë kritike reflektive dhe profesionale në procesin mësimor; • të reflektojë mbi përmirësimin e tij në mësimdhënie; • të zbatojë koherencë ndërmjet objektivave mësimore, përmbajtjeve, dhe metodave; • të zbatojë elementet e sistemit të arsimit të dyfishtë në seancat mësimore gjatë vitit shkollor; • të hartojë standarde lëndore të harmonizuara me kualifikimet përkatëse; • të përmirësojë njohuritë pedagogjike dhe profesionale.	– Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Standardet e mësimdhënësit të kulturës së përgjithshme në AFP, i rishikuar – Broshurë Informative nr 5 i AKAFP. – Arsimi dhe Formimi Profesional nr 14.

Kompetenca II: “Kompetenca operative”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • të kryejë veprimtari profesionale që lidhen me aftësitë parashikuese, projektuese dhe lëndore; • të përshkruajë dhe zbatojë veprimtari që mbështesin kualifikimin profesional të nxënësve/kursantëve sipas profilin të përzgjedhur; • të përshtasë përmbajtjen mësimore me standardet profesionale dhe kushtet reale të punës; • të kontribuojë në përditësimin e përmbajtjeve mësimore në funksion të zhvillimit të teknologjisë dhe profesionale; • të ilustrojë me shembuj konkretë orientimin e nxënësve për profesionin, në drejtimin dhe profilin profesional përkatës; • të nxisë nxënësit të kuptojnë rrugët e zhvillimit profesional dhe mundësitë e punësimit; • të nxisë vetëdijen që në fazat e hershme të formimit; • të marrë pjesë aktive në përditësimin e të reja në profesion; • të zbatojë metodologji organizative të improvizimit pedagogjik; • të ndjekë praktika profesionale bashkëkohore dhe trajnime mbi zhvillimin teknologjik që kanë lidhje me fushën përkatëse; • të përdorë strategji fleksibël dhe elemente të improvizimit pedagogjik për përballimin e situatave të ndryshme mësimore dhe sfida në klasë ose në mjedisin praktik; • të reagojë në mënyrë profesionale ndaj ndryshimeve, kufizimeve ose nevojave të paparashikuara gjatë procesit mësimor; • të kontribuojë në përfshirjen e aktorëve të tjerë të sistemit (biznese, mentorë, institucione) për përmirësimin e formimit profesional; • të kontribuojë në bashkëpunimin e nxënësve për integrimin e mjedisit në kushtet e punës reale.	– Lista kombëtare e kualifikimeve në AFP. https://www.akafp.gov.al/lista-kombetare-e-kualifikimeve/ – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Arsimi dhe Formimi Profesional, nr 13. – Dokumente dhe udhëzime të AKAFPK-së mbi arsimin profesional dhe orientimin e tyre.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	
Kompetenca I: “Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet: • të njohë rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; • të demonstrojë zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor; • të dallojë normën letrare nga përdorimet dialektore, bisedore ose jo standarde; • të njohë rregullat e shkrimit të drejtë të fjalëve, trajtave gramatikore, shenjave të pikësimit dhe përdorimit të shkronjave të mëdha; • të tregojë korrektësinë e rregullave të drejtshkrimit gjatë zhvillimit të veprimtarive mësimore; • të aplikojë me saktësi normën e drejtshkrimit në lidhjen e materialeve mësimore, planeve, testeve dhe dokumentacionit pedagogjik; • të shërbejë si model gjuhësor për nxënësit/kursantët për mësimin e gjuhës shqipe standarde; • të zbatojë rregullat e drejtshkrimit në komunikimin zyrtar dhe institucional (shkresa, njoftime, raporte, e-mail-e zyrtare); • të demonstrojë korrektësinë gjuhësore në dokumentacionin administrativ dhe profesional; • të demonstrojë qartësi, saktësi dhe profesionalizëm në të gjitha format e komunikimit të shkruar;	– Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave të Shqipërisë. – Literaturë/udhëzues metodikë për ndryshimet e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. – Fjalor për Arsimin dhe Formimin Profesional, Pajtim Bejtja, Maksim Konini, Alqi Mustafaj. – Fjalorë normative dhe burime zyrtare të gjuhës shqipe.

• të identifikojë dhe korrigjojë gabime drejtshkrimore në materiale mësimore dhe dokumente profesionale; • të përdorë burime gjuhësore (fjalorë, drejtshkrim, udhëzues) për verifikimin e formave të sakta; • të nxisë ndërgjegjësimin gjuhësor dhe kulturën e shkrimit korrekt te nxënësit/kursantët; • të zbatojë rregullat e drejtshkrimit edhe në terminologjinë profesionale të fushës përkatëse; • të përdorë procese korrekte të terminologjisë së AFP-së në materiale mësimore dhe dokumente zyrtare; • të kontribuojë në mësimin e gjuhës korrekte gjatë procesit dhe profesional.	
--	--

4. Model pyetjesh të provimit të kualifikimit për kategorinë “Mësues i kualifikuar” dhe “Mësues specialist”

1. Skeletkurrikula e Arsimit Profesional në Shqipëri është: 1 pikë
- A) me strukturë që ka si bazë lëndët mësimore.
 - B) me strukturë që ka si bazë modulet mësimore.
 - C) me strukturë të kombinuar.
 - D) me strukturë që ka si bazë projektet mësimore.
2. Bazuar në udhëzimin “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP”, **NUK** mund të jetë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Provimit Përfundimtar Praktik (KVPP) në ofruesin publik të AP-së: 1 pikë
- A) përfaqësues nga drejtoria e shkollës.
 - B) përfaqësues nga biznesi rajonal.
 - C) mësimdhënës i praktikave profesionale.
 - D) mësimdhënës i teorisë profesionale.
3. Në kurrikulën e Arsimit Profesional në nivel ofruesi në Shqipëri, bëjnë pjesë: 1 pikë
- A) programet e Kurseve të Unifikuara të Formimit Profesional.
 - B) planet mësimore të Arsimit Profesional.
 - C) skeletkurrikulat e kualifikimeve profesionale.
 - D) lista kombëtare e profesioneve.
4. Përzgjedhja e modulit/moduleve me zgjedhje të detyruar (nga lista e moduleve të ofruara në skeletkurrikul) bëhet nga vetë shkolla, duke konsideruar: 1 pikë
- A) materialin mësimor teorik.
 - B) numrin e nxënësve në klasë.
 - C) planin e mësimdhënies.
 - D) kërkesat e tregut rajonal të punës.
5. Koordinatori për sigurimin e cilësisë në nivel ofruesi është: 1 pikë
- A) drejtori i institucionit ofrues të AFP.
 - B) një nga kryetarët e departamenteve/ekipeve lëndore.
 - C) përgjegjësi i Njesisë së Zhvillimit.
 - D) një nga përfaqësuesit e biznesit.
6. Objektivi specifik mësimor është i plotë kur përmban: 1 pikë
- A) veprimtarinë dhe objektin.
 - B) veprimtarinë, objektin dhe kushtet e kërkesat.
 - C) objektin dhe kushtet e kërkesat.
 - D) veprimtarinë dhe kushtet e kërkesat.
7. Cila është forma më tipike e paraqitjes së përmbajtjes të lëndëve teorike profesionale, 1 pikë

në planin e mësimdhënies së lëndës?

- A) Veprimtaria mësimor;
- B) Çështja mësimore;
- C) Rezultati mësimor;
- D) Kërkesat për realizim;

8. Cila nga metodat mësimore të mëposhtme është më e përdorshme për mësimin e orientuar kah teoria? 1 pikë

- A) Diskutimi;
- B) Loja me role;
- C) Simulimi;
- D) Demonstrimi;

9. Metoda mësimore është interaktive kur: 1 pikë

- A) mësuesi shpjegon dhe nxënësit dëgjojnë.
- B) mësuesi shfrytëzon përvojat e nxënësve.
- C) nxënësit nxiten të mësojnë vetë.
- D) nxënësit punojnë në grupe.

10. Synimet e lëndëve teorike profesionale janë pjesë e: 1 pikë

- A) skeletkurrikulës.
- B) planit vjetor të shkollës.
- C) planit të orëve të lira.
- D) planit edukativ.

11. Planifikim i mësimdhënies do të thotë:

1 pikë

- A) të ndërtosh në mënyrë strategjike orën e mësimin.
- B) të vësh në zbatim parimet e mësimdhënies.
- C) të përcaktosh kohën e çdo veprimtarie mësimore.
- D) të planifikosh vlerësimin e nxënësve sipas niveleve.

12. Vlerësimi i produktit të punës që kryejnë nxënësit gjatë praktikës profesionale bëhet me: 1 pikë

- A) test të njohurive për produktin e realizuar.
- B) pyetje – përgjigje për produktin e realizuar.
- C) matje të parametrave të produktit të realizuar.
- D) test të procedurës së punës të realizuar.

13. Vlerësimi i shprehive praktike të nxënësve bazohet në: 1 pikë

- A) përmbajtjet mësimore.
- B) metodat mësimore.

C) kushtet për vlerësim.

D) kriteret e vlerësimit

14. Cili nga instrumentet e mëposhtëm përdoret më së shumti për të vlerësuar nivelin e përvetësimit të njohurive? 1 pikë

A) Pyetje-përgjigje me gojë;

B) Lista e kontrollit;

C) Projekti praktik;

D) Studime të rasti;

15. Udhëzuesi i punës shërben si bazë për të ndërtuar: 1 pikë

A) testin me shkrim.

B) listën e kontrollit.

C) planin e mësimdhënies.

D) ditarin.

16. Cili nga llojet e vlerësimeve e ndihmon mësuesin të gjejë shkaqet e mangësive në arritjet e nxënësve? 1 pikë

A) Vlerësimi diagnostikues;

B) Vlerësimi i vazhdueshëm;

C) Vlerësimi përfundimtar;

D) Vlerësimi paraprak;

17. Përparësi e mësimit digjital është: 1 pikë

A) mungesa e komunikimit ballë për ballë.

B) mësimi i personalizuar.

C) kufizimi në disiplina të caktuara.

D) të shkaktuarit e izolimit shoqëror.

18. Realizimi i komunikimit midis mësuesit dhe nxënësit, gjatë një ore mësimore konsiston në: 1 pikë

A) planifikimin e një ore mësimore.

B) përgatitjen e materialeve mësimore.

C) transmetimin e një mesazhi.

D) përzgjedhjen e bazës materiale.

19. Në procesin mësimor, krijon barrierë komunikimi: 1 pikë

A) mirëkuptimi.

B) motivimi.

C) gjurmimi.

D) gjuha e folur.

1 pikë

20. Reagimi i individëve ndaj situatave të ndryshme në kontekstin jetësor ose profesional konsiderohet:

- A) Qëndrim;
- B) Njohuri;
- C) Shprehi;
- D) Shkathtësi;

21. Shkruani 5 (pesë) nga dallimet e kurrikulës së arsimit profesional kraharuar me kurrikulën e arsimit të përgjithshëm.

5 pikë

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

22. Plotësoni vendin bosh me një nga shprehjet e mëposhtme:

1 pikë

_____ është një seri hapash të lidhur me njëri - tjetrin, që ndërmerren, për të përmbushur një detyrë pune (shërbim ose produkt).

“Koncepti; Procedura; Procesi; Kualifikimi”

23. Shënoni përbri çdo pohimi me (V) nëse pohimi është i vërtetë ose me (G) nëse pohimi është i gabuar.

5 pikë

- A. ____ Vlerësimi i nxënësve kërkon nga mësimmhënësi që të përshtasë teknikat e vlerësimit me situatën mësimore.
- B. ____ Një nga sfidat më të mëdha të mësimmhënësve është të mësojnë si të trajtojnë nxënësit kur japin përgjigje të gabuara.
- C. ____ Mësimmhënësi duhet të ketë rol absolut në vlerësimin e nxënësve.
- D. ____ Nota për modulin llogaritet si mesatare e ponderuar e vlerësimeve për çdo Rezultat të të Nxënës (RN).
- E. ____ Që vlerësimi të konsiderohet i besueshëm duhet që ai t'i referohet objektivave mësimore.

24. Hartoni tre objektiva mësimore sipas kërkesave të mëposhtme:

3 pikë

1. I referohet fushës njohëse:

2. I referohet fushës afektive:

3. I referohet fushës psikomotore:

4 pikë

25. Listoni 4 (katër) nga metodat mësimore që nxisin aktivizimin e nxënësve.

26. Rendisni 3 shkaqe të krijimit të barrierave në komunikimin me nxënësit në klasë: 3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

27. Listoni dy nga kushtet që duhet të përmbushë mjedisi mësimor, në aspektin fizik. 2 pikë

- a) _____
- b) _____

28. Listoni dy nga përparësitë e përdorimit të multimedieve mësimore në procesin mësimor. 2 pikë

- a) _____
- b) _____

29. Pëgjigjuni pyetjeve të mëposhtme. 3 pikë

- a) Cila është një nga masat që ndërmerret për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në ditët e sotme, sipas fushës suaj të ekspertizës? 1 pikë

- b) Cilat janë dy nga risitë e digjitalizimit në fushën tuaj të ekspertizës? 2 pikë

1. _____
- _____
2. _____
- _____

30. Në fjalët/ grupfjalët e mëposhtme, identifikoni dy fjalët/ grupfjalët e shkruara gabim dhe shkruajini saktë ato. 2 pikë

Kompetencë; Demostrim; Praktikë e pavarur; Standarte; Platformë digjitale.

- a) _____
- b) _____

5. Model i një seance mësimore të hapur për të fituar kategorinë “Mësues mjeshtër”

Model 1 – Seancë mësimore teorike

Ora 2

Datë: __12.2025

Klasa 12^A

Kualifikimi profesional: Tregti, Niveli IV i KSHK-së

Lënda: Ekonomi e përgjithshme (L-17-635-23)

Tema: Strukturat e tregut, analizë krahasuese.

Çështja: Konkurenca. Kuptimi i strukturave të tregut.

Kohëzgjatja: 1 orë mësimore

Objektivat e çështjes:

Në fund të çështjes nxënësi duhet:

- Të shpjegojë qartë rolin e konkurrencës në ekonominë e tregut.
- Të përshkruajë tiparet e strukturave të tregut duke u bazuar te konkurrenca.
- Të identifikojë struktura tregu duke u bazuar në tiparet e secilës strukturë.

Zhvillimi i orës mësimore

Faza	Kohëzgjatja/ Min	Aftësitë e buta	Metodat mësimore	Material/ Media	Vënia në zbatim
------	---------------------	-----------------	---------------------	--------------------	-----------------

Hyrja (Parashtrimi)	7 min	Përfshirja në mënyrë aktive e të gjithë nxënësve në diskutim.	Stuhi mendimesh	Smart TV, material në PPT, flipçart, markera	Hapi i parë: Prezantimi i temës, çështjes dhe objektivave mësimore. <i>“Kam qenë kundër konkurrencës së ashpër gjatë gjithë jetës sime: Në fakt nuk di si t’ia bëj pa të.”</i> ~ Walt Disney Si do ta shpjegonit ju shprehjen e mëposhtme në lidhje me konkurrencën. A ndani dhe ju të njëjtin mendim me Walt Disney?
------------------------	-------	---	-----------------	--	--

Zhvillimi (Ndërtimi i njohurive)	23 min	Aktivizimi dhe bashkëpunimi i nxënësve në ndërtimin e njohurive të reja. Komunikimi qartë i ideve të tij. Respektimi i mendimit të tjerëve.	Diskutim Shpjegim Ilustrim me shembuj Punë individuale	Tabelë e bardhë, markera, magnetë Smart Tv/tableta, materiale mësimore mbështetëse të përgatitura nga mësuesi dhe nga platforma mesovet, PPT https://mesovet.al/mod/hvp/view.php?id=14097 Internet	Hapi i dytë: Informacioni i ri. Nxënësit logohen në platformën mesoVet. https://mesovet.al/course/view.php?id=180#section-5 1. <u>Prezantim i informacionit të ri nëpërmjet PPT.</u> - <i>Përkufizimi i konkurrencës</i> - <i>Kuptimi mbi strukturat e tregut.</i> 2. <u>Punë individuale:</u> Pasi u informuan në lidhje me konkurrencën, nxënësve u jepet nga një pankartë me një lloj biznesi dhe u kërkohet të bëjnë vetë një rënditje të strukturave të tregut bazuar në konkurrencën, të cilat janë vendosur në tabelën e bardhë. Nxënësit janë të lirë ta vendosin si ta mendojnë ata pa qenë e nevojshme të marrin informacionin e ri. 3. <u>Prezantim i informacionit të ri nëpërmjet PPT.</u> - <i>Klasifikimi i strukturave të tregut bazuar në konkurrencën</i> - <i>Tiparet e strukturave të tregut</i> Njohuritë e reja jepen edhe duke nxitur diskutimin me nxënës në lidhje me tiparet që mund të karakterizojë një strukturë tregu. Tiparet që karakterizojnë një strukturë tregu: - <i>Numri i firmave në treg</i> - <i>Madhësia e tyre</i> - <i>Lehtësia për të hyrë dhe për të dalë nga tregu</i>
---	---------------	--	---	--	---

Përfundimi (Përforcimi)	13 min	Realizimi i kuicit me korrektësi dhe saktësi brenda afatit të lejuar. Bashkëpunimi me mësimdhënësin në dhënien e feedback-ut.	Punë individual, detyrë klase, diskutim	Mesovet.al https://mesovet.al/mod/quiz/view.php?id=50764 tabelë e bardhë, markera kompjuter/tableta, internet	Hapi i tretë: Realizimi i një kuici përmbledhës nga secili nxënës nëpërmjet platformës mesovet për çështjet kryesore të trajtuara gjatë orës mësimore. - Pas realizimit të kuicit, prezantohen rezultatet nga platforma. - Në fund bëhet vlerësim i rezultateve të kuicit duke evidentuar pyetjet më me shumë përgjigje të gabuara. Sqarim i koncepteve të paqarta. Hapi i katërt: Vlerësim i nxënësve (Mësimdhënësi mban shënime në evidencën/fletoren regjistër rezultatet e kuicit për secilin nxënës si dhe aktivizimin e tyre në punët individuale dhe në diskutime. Gjithashtu, nxënësi vlerësohet në bazë të aktivizimit, saktësisë dhe sigurisë në kryerjen e detyrave dhe dhënien e përgjigjeve të sakta. - Në vlerësimin e nxënësve përfshihen dhe aftësitë e buta si: etika e komunikimit, bashkëpunimi, përfshirja në diskutim.
Detyrat e shtëpisë (2 min)					Me anë të diagramës së Venit tregoni të përbashkëtat dhe të veçantat ndërmjet këtyre strukturave të tregut: 1. Konkurrencës së plotë dhe konkurrencës monopolistike. 2. Monopolit dhe oligopolit. Detyra e shtëpisë duhet të dërgohet nëpërmjet dokumentit në platformë brenda afatit të përcaktuar. https://mesovet.al/mod/assign/view.php?id=50762&forceview=1

Refleksione mbi zhvillimin e orës mësimore: A u arritën objektivat e orës? Cila strukturë tregu krijoi më shumë paqartësi? Çfarë do të përmirësohet në orën pasardhëse? A u pëfshinë të gjithë nxënësit në orën mësimore?

Model 2 – Seancë mësimore praktike

Ora 2

Datë: ____ .12.2025

Klasa 11^A

Kualifikimi profesional: Hoteleri - Turizëm, Niveli II i KSHK-së

Moduli: Shërbimi në bar (M-13-2002-24)

RN 2: Nxënësi përgatit dhe shërben pije të ngrohta.

Veprimtaritë mësimore:

- Demonstrim i përgatitjes së kafesë ekspres sipas procedurës;
- Praktikim i mbikëqyrur i përgatitjes së kafesë ekspres sipas procedurës.

Kohëzgjatja: 1 orë mësimore

Objektivat mësimore:

Në fund të orës mësimore nxënësi duhet:

- Të përgatisë kafënë ekspres sipas procedurës standarde, duke respektuar kërkesat teknike dhe standardet e cilësisë.
- Të demonstrojë përgjegjshmëri, komunikim korrekt dhe bashkëpunim gjatë përgatitjes së kafesë, duke respektuar rolet, kohën dhe udhëzimet e dhëna.

Metodat mësimore: Stuhi mendimesh, demonstrim, praktikë e mbikëqyrur, pyetje-përgjigje me gojë

Kërkesat për realizim: Bar i shkollës, makinë ekspresi, kafe ekspres jo e bluar, mulli kafeje (automatik), portafilter dhe tamper, filxhanë ekspresi, lugë matëse, filtra, peceta, ujë i pastër për makinën dhe shërbim kafe ekspres, manual për përdorimin e makinës ekspres, udhëzues pune.

Zhvillimi i orës së mësimi

Hapat e punës për realizimin e veprimtarive:

Faza e parë (7 minuta):

- Mësimdhënësi përshëndet nxënësit, prezanton objektivat dhe veprimtaritë e orës mësimore dhe krijon lidhjen logjike me njohuritë e mëparshme.
- Pyetjet që mund t'i bëhen nxënësve në këtë fazë hyrëse mund të jenë: A ju ka qëlluar ndonjëherë gjatë praktikës profesionale ose në një mundësi tjetër të bëni kafe ekspres? Nëse po, përshkruajeni mënyrën se si e keni realizuar me jo më shumë se dy fjali.

Faza e dytë (7 minuta): Mësimdhënësi demonstroi përgatitjen e kafesë ekspres sipas procedurës duke e demonstruar dhe shpjeguar hap pas hapi procesin si dhe rregullat e sigurimit teknik dhe higjienës:

- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së higjienës si një kriter shumë i rëndësishëm në kryerjen e veprimtarive.
- Përgatitja e portafilter-it dhe vendosja e kafesë së bluar në masën e duhur.

- Tampimi korrekt i kafesë në portafilter.
- Vendosja e portafilter-it në makinën e ekspresit dhe fillimi i nxjerrjes së kafesë.
- Vlerësimi i cilësisë së kafesë: aroma, shija, sasia dhe kritere të tjera të rëndësishme.



Nxënësit vëzhgojnë me kujdes çdo hap, shënojnë pyetje dhe diskutojnë për gabimet e zakonshme që duhet të shmangen.

Theksohet rëndësia e higjienës dhe sigurisë gjatë përdorimit të makinës së ekspresit.

Faza e tretë (20 minuta): Praktikim i mbikëqyrur i nxënësve i përgatitjes së kafesë ekspres

- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale në postet e punës, duke zbatuar udhëzimet dhe procedurat e demonstruara më parë nga mësuesi.
- Secili nxënës përgatit kafe ekspres duke ndjekur të gjithë hapat e procesit:
 - o përzgjedhjen dhe bluarjen e kafesë në granulacionin (trashësinë) e duhur;
 - o vendosjen e kafesë së bluar në portafilter;
 - o tampimin korrekt dhe të njëtrajtshëm;
 - o vendosjen e portafilter-it në makinën e ekspresit dhe nxjerrjen e kafesë në kohën e duhur.
- Nxënësit vëzhgojnë dhe vlerësojnë rezultatin e punës së tyre, duke analizuar cilësinë e kafesë (shkuma, aroma, shija dhe sasia).
- Gjatë praktikimit, nxënësit reagojnë ndaj feedback-ut të dhënë nga mësuesi dhe korrigjojnë menjëherë gabimet teknike të konstatuara.
- Nxënësit respektojnë rregullat e higjienës personale dhe të ambientit të punës, si dhe masat e sigurisë gjatë përdorimit të makinës së ekspresit.

Vlerësimi me anë të listës së kontrollit dhe pyetje-përgjigje me gojë (6 minuta): Nxënësit vëzhgohen nga mësuesi me listë kontrolli për procedurën e punës, produktin përfundimtar (kafenë ekspres) si dhe me pyetje të hapura dhe të mbyllura me gojë. Gjithashtu pjesë e vlerësimit janë edhe aspekte të qëndrimit dhe komunikimit si:

- Bashkëpunimi
- Kreativiteti
- Gatishmëria për të pranuar sugjerimet

- Komunikim i qartë dhe respektues
- Menaxhimi i kohës
- Përgjegjshmëria dhe vetëkontrolli në kryerjen e veprimeve

Refleksione (5 minuta):

- Diskutim i shkurtër mbi procesin: çfarë doli mirë, çfarë mund të përmirësohet.
- A i zbatuan nxënësit saktë procedurat e përgatitjes së kafesë?
- Cilat hapa rezultuan më problematikë (tampimi, shkumëzimi, koha e nxjerrjes etj)?
- A ishte koha e praktikimit e mjaftueshme?
- Çfarë duhet të rishikohet në orën e ardhshme praktike?